

## MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues që ka kryer procesin të rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj – duke e mbështetur vendimmarrjen përfundimtare, por duke mos qenë dakord mbi një pjesë të qëndrimit të mbajtur nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, që ka çuar në disa konkluzione që nuk më gjejnë dakord – në vijim, po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit lidhur me: (i) aplikueshmërinë ose jo në rastin konkret të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr.84/2016; (ii) përlllogaritjen e të ardhurave familjare të subjektit të rivlerësimit; si dhe (iii) mbi peshën dhe pasojat e deklarimeve kontradiktore lidhur me cilësimin e deklarimit të rremë apo me cënimin e besimit të publikut.

1. Në konkluzionet përfundimtare të vendimit në fjalë dhe konkretisht në paragrafin nr. 53, pika (v), përshkruhet sa vijon: *Komisioni mban parasysh në vlerësimin e tij qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ, duke iu përgjigjur në mënyra të ndryshme pyetjeve të njëjta të drejtuara nga Komisioni për çështje të caktuara, për të cilat është kërkuar një shpjegim prej tij, ose është shmangur nga përgjigja. Subjekti i rivlerësimit ka cënuar qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjellje besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.*

1.1. Ndonëse përshkrimi i qëndrimit të subjektit përgjatë përgjete hetimit administrativ përkon me faktet e konstatuara nga Komisioni, unë nuk jam dakord me konkluzionin e arritur, se ky qëndrim në vetvete çon në cënimin e besimit të publikut, për tre arsye që vijnë:

- a- Të gjitha pyetjet e drejtuara subjektit të rivlerësimit lidhen me kriterin e pasurisë, dhe çdo përgjigje apo mospërgjigje e dhënë prej tij i ka prodhuar efektet e veta, për sa kohë ato janë trajtuar, analizuar dhe vlerësuar nga Komisioni në raport me rrethanën konkrete (për qartësimin e të cilave janë drejtuar pyetjet përkatëse). Për rrjedhojë, çdo përgjigje e subjektit që ka rezultuar si e pasaktë, e paplotë, kontradiktore apo e mbështetur/pambështetur në prova, i ka pasjellë efektet përkatëse në dy rrafshet e mundëshme, objekt vlerësimi: (i) lidhur me problematikat e mundëshme të deklarimeve të subjektit si dhe (ii) lidhur me mjaftueshmërinë ose jo të burimeve financiare të ligjshme. Në këto kushte, në vlerësimin tim, pasojat e qëndrimit të subjektit në raport me pyetjet apo me rezultatet e njoftuara, janë përthithur nga vlerësimi dhe vendimmarrja specifike për çdo gjetje për të cilën është kaluar barra e provës, duke pasjellë pasojat e rastit – pra shkarkimin e subjektit të rivlerësimit në bazë të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë këndvështrim përgjigjet, veprimet dhe qëndrimet e subjektit brenda perimetrit të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë e kanë ezauruar forcën e tyre provuese, së bashku me efektet pozitive dhe/ose me pasojat e tyre, tashmë të vlerësuar. Ripërdorimi i këtyre rrethanave, (që lidhen sërish me përgjigjet dhe qëndrimet e subjektit), për të arritur në aplikimin e një tjetër mase, në bazë të pikës 5 të nenit 61, të ligjit 84/2016, do të rezultonte si një mbivendosje penalizimi, përtej parimit të proporcionalitetit.

b- Nga ana tjetër, sa më lart, paraqet kuadrin e qasjes së subjektit në kornizën e komunikimit të rezervuar midis Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit, dhe nuk kuptohet koha dhe mënyra se si publiku mund të ketë rënë në dijeni të këtyre fakteve, që më pas ato mund të kenë passjellë cënimin e besimit të tij ndaj subjektit, dhe/ose ndaj sistemit të drejtësisë. Për sa më sipër dhe në mungesë të qartësisë ndërlidhëse shkak-pasojë, të rrethanave në fjalë me besimin e publikut, nuk e konsideroj të bazuar, në rastin konkret, aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit 84/2016.

2. Në vendimin në fjalë, në paragrafin 41.4.4 lexohet se: *Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se ato nuk përputhen me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ, ku ai në përgjigje të pyetësorit të datës 03.04.2020 në pikën 28/c ka deklaruar se duke filluar nga maj i vitit 1998 nuk ka jetuar me prindërit e tij. Gjithashtu subjekti në deklaratën Vetting nuk ka përcaktuar sa ka qenë shuma e dhënë nga prindërit e përdorur prej tij për blerjen e apartamentit apo krijimin e depozitave. Nga ana e subjektit në deklaratën Vetting tek seksioni “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhura të krijuara prej tyre” nuk rezulton të jetë deklaruar të ardhurat nga prindërit e tij. **Për sa më sipër Komisioni vlerëson se të ardhurat e prindërve të subjektit nuk do të përfshihen në analizë financiare.***

Po ashtu edhe në disa paragrafe pararendës, pasqyrohet qëndrimi i subjektit dhe konfirmohet vlerësimi i trupës për moskonsiderimin në analizën financiare të ardhurave të prindërve, që rezultojnë si anëtarë të familjes së subjektit të rivlerësimit. Konkretisht në paragrafin 40.4: *Subjekti në deklaratën Vetting ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 2,140,000 lekë për periudhën 2005-2016. I është kërkuar subjektit të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për shumën e përfutur nga ana e tij nga përdorimi i tokës bujqësore, ku të dalë qartë dhe pagimi i detyrimeve tatimore. Nga ana e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1 është deklaruar se shuma e përfutur nga të ardhurat e tokës bujqësore, vreshtit dhe ullinjve nuk është e dokumentuar. Për këto të ardhura nuk ka dokumentacion tatimor, pasi veprimtaria është ushtruar si fermer. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi ato janë thjesht deklarative, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion për të vërtetuar se babai apo nëna e tij kanë qenë të regjistruar si fermer.*

Ndërsa në paragrafin 40.4.1 pasqyrohet rezultati i kaluar si barrë prove, ku konkludohet se: *Për sa më sipër, subjekti iu kalua barra e provës: (i) Subjekti nuk ka vendosur në dispozicion të Komisionit asnjë dokumentacion për të vërtetuar të ardhurat e përfutur nga toka bujqësore. (ii) **Subjekti nuk ka vë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për pagimin e taksave/tatimeve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e tokës bujqësore, për rrjedhojë këto të ardhura nuk do të merren në konsideratë në analizën financiare.***

2.1 Lidhur me këtë pikë, mendimi ndryshe konsiston në faktin se vlerësohet se nuk mund të përjashtohet përlllogaritja e disa të ardhurave të pretenduara, thjesht për mungesë të paraqitjes së provave lidhur me: (i) qenien ose jo të prindërve të subjektit, anëtarë të trungut familjar të tij – për sa kohë kjo është e provuar nga çertifikata familjare (së paku deri në vitin 2002), dhe kjo rrethanë nuk mund të ç’bëhet nga pohimi i tij se për një periudhë kohe nuk kanë jetuar bashkë; (ii) shpenzimet e investimit, për mbjellje ullinjsh dhe vreshti në tokën *de qua*, të kryera disa dekada më herët, (iii) pagesën e tatimeve, - për sa kohë aktiviteti i pretenduar nuk ka qenë objekt tatimpagues; (vi) pagesën apo jo të taksave vendore, të

ndricimit etj, - për sa kohë këto të fundit nuk mund të afektojnë ligjshmërinë e burimit të krijuar nga aktiviteti në fjalë. (v) mosspecifikimin e shumave konkrete si të ardhura të prindërve në deklaratën vetting – duke konsideruar vështirësitë teknike, si pasojë e mosmbajtjes së një kontabiliteti të mirëfilltë, kohës së gjatë dhe paqartësisë së informacioneve nga vet subjekti, dhe për sa kohë nga ai është paraqitur një akt ekspertize kontabël mbi të ardhurat e mundëshme nga toka e disponuar dhe nga aktiviteti bujqësor i pretenduar – i cili në praninë e plotësimit të kushteve të tjera, mund të merret në konsideratë, qoftë edhe pjesërisht.

2.2. Në vijim të sa më lart, duhet gjithashtu qartësuar se moskonsiderimi në analizën financiare i këtyre të ardhurave mund të gjejë mbështetje të pjesëshme në faktin e mosprovueshmërisë së ekzistencës së aktivitetit, të nivelit të kultivimit dhe prodhimit të gjeneruar nga kjo tokë e ndërthurur kjo edhe me pohimin e vetë subjektit, në një moment të caktuar, se kultivimi i tokës në fjalë nga ana e prindërve të tij nuk kishte patur si qëllim gjenerimin e të ardhurave. Por nga ana tjetër, nuk duket koherent me sa më lart marrja në konsideratë e disa të ardhurave të prindërve të subjektit të rivlerësimit, vetëm në vitin 2015, kur ata sigurisht nuk ishin më anëtarë të familjes së subjektit.

Së fundmi, theksohet fakti se marrja ose në konsideratë e të ardhurave të pretenduara ose të një pjese të tyre, nuk do të përmbyste rezultatin e analizës financiare në tërësi, dhe për rrjedhojë nuk do të ndryshonte as vendimmarrjen finale të Komisionit.

3. Gjithshtu, përgjatë vendimit në fjalë janë referuar disa rethana, të cilat - për sa kohë përbënin një qëndrim (apo përgjigje) kontradiktor/e të subjektit, lidhur me ndryshimin e identifikimit të një burimi financiar – ngrinin dyshime se subjekti kishte kryer deklaram të rremë. Ndërsa në mënyrë të përsëritur në vendim është referuar se ai është përpjekur të deformojë apo të fshehtë të vërteten, duke ndryshuar pozicionim në pohimet/përgjigjet/prapsimet e tij. Edhe në këtë rast, mendimi paralel nuk pajtohet me ekzistencën e ndonjë deklarimi të rremë në këto rethana, pasi nuk përmbushen kriteret e cilësimit të një deklarimi si i rremë. Gjithashtu, konsiderohet se edhe deklaramet kontradiktore, që janë vlerësuar nga Komisioni duke prodhuar efektet repektive – siç është argumentuar edhe në pikën 1 të këtij mendimi ndryshe, nuk mund të çojnë konkluzione që bazohen mbi interpretimin e qëllimit apo të ideve/mendimeve të prezumuara apo të interpretuara nga Komisioni, dhe jo mbi analizën faktiko ligjore të fakteve të konstatuara.

**ANËTARI I TRUPIT GJYKUES**  
**(me mendim paralel)**  
**Lulzim Hamitaj**